

URDHËR
Nr. 70, datë 17.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, për nënshkrimin e urdhrave të lëshimit të lejeve (*diplomatic clearance*) për hyrjen, uljen e kalimin e mjeteve lundruese ushtarake, të mjeteve fluturuese ushtarake dhe mjeteve të transportit, dhe/ose të blinduara ushtarake të huaja, në hapësirën ajrore, detare dhe territoriale të Republikës së Shqipërisë, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Hantin Bonati.

2. Z. Hantin Bonati të ndjekë dhe zbatojë kriteret dhe procedurat e përcaktuara në vendimin nr. 357, datë 13.6.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e lëshimit të lejeve (*diplomatic clearance*) për hyrjen, uljen e kalimin e mjeteve lundruese ushtarake, të mjeteve fluturuese ushtarake dhe mjeteve të transportit dhe/ose të blinduara ushtarake të huaja, në hapësirën ajrore, detare dhe territoriale të Republikës së Shqipërisë”, gjatë ushtrimit të fushës së përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri dhe legjislacionin në fuqi.

3. Urdhri nr. 14, datë 13.1.2026, i zëvendëskryeministrit dhe i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Hantin Bonati, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi